

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaCem® Désactivant 2-4

VONUËS NË FAZË UJORE I MPIKSJES SË SIPËRFAQES TË BETONIT, ME PERFORMANCË TË LARTË MATURIMI

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaCem® Désactivant 2-4 është një vonues në fazë të lëngët i mpiksjes së sipërfaqes i cili deaktivon në një thellësi prej 2–4 mm. SikaCem® Désactivant 2-4 ofron një performancë të shkëlqyer maturimi.

PËRDORIMET

SikaCem® Désactivant 2-4 rekomandohet për sipërfaqe dekorative horizontale, si:

- zona këmbësorësh
- rrugicat përreth vilave, oborre
- zonat përreth pishinave
- barrierat me beton të injektuar

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

SikaCem® Désactivant 2-4 lejon deaktivizimin në thellësi nga 2 deri në 4 mm dhe duhet të përdoret me granulometri D_{max} nga 6 deri 12 mm.

SikaCem® Désactivant 2-4 ofron avantazhet e mëposhtme:

- pamje estetike me agregate të ekspozuara
 - pa rrëshqitje për automjetet dhe këmbësoret.
- Përformancat e maturimit të SikaCem® Désactivant 2-4 sipas standardit francez NFP 18-370 janë shumë të larta:
- 100% në 6 orë,
 - 99% në 24 orë.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ambalazhi	Bidon 5 L dhe 20 L
Jetëgjatësia	12 muaj nga ambalazhi origjinal i pahapur. Pas përdorimit, ambalazhi duhet të mbyllet me kujdes dhe produkti i mbetur duhet të përdoret brenda një kohe të shkurtër.
Kushtet e magazinimit	Të magazinohet në temperatura nga +5°C deri në +30°C. Të mbrohet nga ngrica dhe temperatura e lartë. Nëse SikaCem® Désactivant 2-4 ka ngrirë, mund të fitojë vetitë e tij origjinale pasi të magazinohet në temperaturë të ngrohtë dhe të përziehet.
Dendësia	≈ 1
Vlera e pH	≈ 6

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	1 litër për 4 deri në 5 m ²
Temperatura e mjedisit	Gjatë aplikimit, temperatura e ajrit, produktit dhe nënshtresës duhet të jenë midis +5°C dhe +35°C.

UDHËZIME APLIKIMI

Rekomandohet përgatitja e një sipërfaqeje prej ~ 1 m² përveç kantierit ku po kryhen punimet, për të ndihmuar në vlerësimin e kohës së duhur për nisjen e larjes.

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Mbroni zonën rrethuese të kantierit nga hedhja aksidentale e SikaCem® Désactivant 2-4 gjatë spërkatjes apo rrjedhja me një fletë plastike ose një produkt mbrojtës si SikaCem®Film.

APLIKIMI

- Homogjenizoni produktin përpara përdorimit.
- Pasi të ketë përfunduar nivelimi, spërkasni SikaCem® Désactivant 2-4 në mënyrë të njëtrajtshme mbi të gjithë sipërfaqen e betonit që do të trajtohet, duke përdorur një shtupë të butë.
- Për rezultate më të mira, lagni paraprakisht sipërfaqen dhe prisni për disa minuta.
- Shpëlani sipërfaqen me curril uji në presion të lartë (max. 100-150 bar). Në varësi të kushteve të motit (temperatura, dielli, era), faza e deaktivizimit zakonisht do të fillojë ndërmjet 5 dhe 24 orësh.
- Në rast se do të bierë shi gjatë këtij deaktivizimi brenda 3 orëve pas spërkatjes, rekomandohet deaktivizimi i menjëherëshëm.
- Nëse shpëputet ndonjë agregat gjatë shpëlarjes, zvogëloni presionin e shpëlarjes ose prisni pak më tepër.
- Pas larjes, këshillohet përdorimi i SikaCem® Cure si ndihmues i procesit të mpiksjes.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
SikaCem® Désactivant 2-4
Korrik 2019, Botimi 04.01
021405011000000045

SikaCemDsactivant2-4-sq-AL-(07-2019)-4-1.pdf

